



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës
 Ministarstvo za Kosovske Bezbednosne Snage / Ministry for the Kosova Security Force

Departamenti i Personelit/ Odsek za personal/Department for Personnel

Në mbështetje të nenit 145, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe në pajtim me Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Kreu III, Neni 11 i këtij Ligji, Neni 15 i Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës shpall këtë:

KONKURS

<u>Titulli i vendit të punës:</u>	<u>Inxhinier</u>
Kategoria funksionale dhe grada e vendit të punës:	Grada A2
Nr. referencës së vendit të punës:	2334
Vendi:	MFSK

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Harton planin zhvillimor afatshkurtër, afatmesëm dhe afatgjatë të infrastrukturës për lokacionet e kazermave të FSK-së.
- Planifikon dhe mbikëqyr kontratat në projekte të infrastrukturës në kazemat e FSK-së.
- Bashkëpunon me departamentet dhe sektorët tjerë të MFSK-së dhe FSK-së në lidhje me projektet e infrastrukturës .
- Vlerëson gjendjen e infrastrukturës së përgjithshme të kazermës , analizon , propozon dhe merr masat për sanimin dhe mirëmbajtjen e tyre .
- Azhurnon , sistemon dhe arkivon dokumentacionin nga fushëveprimi i infrastrukturës.
- Bën vlerësimin e projekteve të infrastrukturës, përgatitë dokumentacionin tekniko –investiv për projekte të infrastrukturës .
- Zhvillon procedura, direktiva dhe rregullore për FSK-në lidhur me vlerësimin e nevojave, mirëmbajtjen, shfrytëzimin dhe riparimin e gjithë pronës së FSK-së.
- Raporton dhe i përgjigjet shefit te Sektorit të Infrastrukturës dhe Mbështetjes.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

- Në shërbimin civil kanë të drejtë të punësohen shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, që posedojnë të drejta civile dhe politike, kanë përgatitje të nevojshme arsimore dhe aftësi profesionale për kryerjen e detyrave ekzekutive, drejtuese ose zbatimin e funksioneve administrative dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.
- Pranimi në Shërbimin Civil të Kosovës mund të kryhet deri në një (1) vit para moshës së pensionimit.

Procedurat e konkurrimit:

- Shpallja e konkursit është e hapur për të gjithë të interesuarit për aplikim.

Shkollimi i kërkuar:

- Diplomë universitare – Inxhinier i ndërtimtarisë.

Aftësitë, përvoja dhe atributet tjera që kërkohen:

- Përvojë profesionale në fushën e ndërtimtarisë.
- Njohuri të mira në programe kompjuterike-Programë projektuese .
- Njohuri të gjuhës shqipe apo serbe dhe angleze.
- Përvojë e nivelit të menaxhimit në institucione private a publike/Agjencia e Mbështetjes Civile/Emergjente (e dëshiruar).
- Përvojë të gjatë si inxhinier i ndërtimtarisë (e dëshiruar).
- Inxhinieri duhet të jetë profesional, me përvojë dhe i besueshëm si dhe i aftë që t'i kryejë në mënyrë profesionale detyrat e dhëna sipas mandatit dhe ato shtesë brenda periudhës së pranueshme kohore.
- Duhet të përdorë maturinë në punë dhe gjatë detyrës me njerëz.
- Duhet të jetë i motivuar dhe me etikë të lartë pune.
- Ai/ajo duhet të posedojë aftësi që të punojë i/e mëvetësishme si dhe të punojë në ekip me punonjës tjerë në përmbushjen e detyrave të dhëna.

Aktet ligjore dhe nënligjore që rregullojnë rekrutimin:

- Procesi i rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës është i bazuar në Ligjin Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil.
- Bazuar në aktet ligjore të lartpërmendura kandidatët të cilët i plotësojnë kriteret e parapara do t'i nënshtrohen shqyrtimit fillestar të aplikacioneve të tyre.
- Konkurruesit më të suksesshëm do të përfshihen në listën e shkurtër dhe do të ftohen të marrin pjesë në testimin me shkrim dhe me gojë.
- Kandidatët që kalojnë testin me shkrim, do t'i nënshtrohen testit me gojë (intervistës). Në fund të procesit përzgjedhës kandidatët e pazgjedhur kanë të drejtë ankese.

Kohëzgjatja e emërimit:

- Emërimi është me afat të pacaktuar, ndërsa kohëzgjatja e periudhës provuese është 12 muaj.

Data e mbylljes së konkursit:

- Konkursi është i hapur pesëmbëdhjetë (15) ditë pas ditës së shpalljes së parë në të përditshmet kosovare.
- Data e fundit e aplikimit është 09.05.2012.
- Aplikacionet e dërguara nëpërmjet postës, me pullë postare, në ditën e fundit të shpalljes, konsiderohen të vlefshme.

Paraqitja e kërkesave:

- Formularët duhet të dorëzohen në Departamentin e Personelit personalisht, apo të dërgohen me postë në këtë adresë: **Ministria e FSK-së, Lagja Emshiri 1, 10000 Prishtinë, Departamenti i Personelit/Spektori i Rekrutimit, Kati II, zyra 216 (Ish-ndërtesa e Shtabit të Përgjithshëm të TMK-së)**, Prishtinë, në çdo ditë pune nga ora 09:00-15:00 deri në afatin e fundit për konkurrim.
- Kandidatët duhet t'ia bashkëngjitin aplikacionit kopjet e dokumenteve të nevojshme personale dhe kopjet e dokumenteve që dëshmojnë për kualifikimet e tij/saj. Dokumentet e pranuar nuk do të kthehen!

Kërkesa specifike:

- Kjo pozitë i nënshtrohet procesit të verifikimit dhe mund të plotësohet vetëm pas përfundimit të suksesshëm të procesit të verifikimit.

Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Komuniteti joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë përfaqësimi proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale, ashtu siç specifikohet në nenin 11. [paragrafin 3 të Ligjit nr. 03/L-149 mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës . Kërkesat e pakompletuara dhe të dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen. Formularët për aplikim janë në dispozicion në Departamentin e Personelit të M-FSK-së, apo në web-faqen e M-FSK-së, www.mksf-rks.org , www.rks-gov.net/mfsk, ku gjendet shpallja e konkursit. Për informata plotësuese mund të kontaktoni në: 038 200 13 508.